

Nr.: 03-171/3  
Shkup : 30.09.2022

Në bazë të nenit 28 paragrafi (5) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e RM, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 nga Ligji për kontrollin e ndihmës shtetërore (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 30.09.2022, solli

### MENDIM

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ka dorëzuar shkresë – Kërkesë nr. 37-4947/2, datë 30.08.2022 (Nr. ynë 03-171/1, datë 05.09.2022) në të cilin Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i kërkohet të japë mendim për:

- Propozim për Programin për përcaktimin e mjeteve të nevojshme për dhënien e mbështetjes financiare për promovimin dhe zhvillimin e trafikut ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut për transportuesit vendas dhe të huaj për periudhën 2022-2025 dhe
- Propozim Dekreti për mënyrën, kriteret më të përafërta për dhënien e mbështetjes financiare për transportuesit ajror vendas dhe të huaj dhe dokumentacionin e nevojshëm që duhet të dorëzohet nga përfituesit e mbështetjes financiare.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës e ka shqyrtuar këtë Kërkesë dhe në lidhje me synimin për të vazhduar këtë lloj mbështetjeje financiare, thekson faktin se Udhëzimet e Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore për aeroportet dhe aviacionin duhet të merren **plotësisht** parasysh (Guidelines on State aid to airports and airlines 2014/C 99/03). Përkatësisht, para fillimit të mundshëm të procedurës së re, është e nevojshme që dhënësi i ndihmës shtetërore, gjegjësisht Ministria e Transportit dhe lidhjeve, në përputhje me nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore t'i dorëzojë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës një Njoftim për dhënien e planifikuar të ndihmës në përputhje me nenin 13 të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 145/10) dhe në përputhje me Dekretin për mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për mbikëqyrjen e ndihmës ekzistuese shtetërore („Gazeta Zyrtare e RM” nr. 142/11). Së bashku me Njoftimin e plotësuar, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve duhet t'i dorëzojë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës edhe versionet përfundimtare të Propozim-Programit dhe Propozim-Dekretit të mësipërm.

Sipas legjislacionit për ndihmën shtetërore, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës tregon se si institucion është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të ndihmës shtetërore - Neni 10 i Ligjit për Kontrollin e ndihmës shtetërore. Rrjedhimisht, në pyetjen nga pika 4 e Memorandumit të dorëzuar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut: nëse materiali përmban elemente të ndihmës shtetërore, përgjigja JO është zgjedhur nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, e cila është në kundërshtim me legjislacionin për ndihmën shtetërore, sepse Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka kompetencën të vlerësojë nëse masat e tilla të konceptuara përbëjnë ndihmë

shtetërore dhe janë në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe si të tillë lejohen për zbatim nga dhënësit e ndihmës shtetërore.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**